



Viti i XIV-të i Botimit, Nr. 2,
Dhjetor 2022

ROLI I PËRRALLAVE NË EDUKIMIN DHE RRIJTJEN E FËMIJËVE; SHQYRTIM LITERATURE

Lorela Garuli*

*Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Albanian University

Përmbledhje

Motivet ekzistenciale dhe konfliktet e trajtuara në përralla shprehin ngjarjet dhe bindjet e hershme të një populli, që pasi vishen me simbole dhe fantazi, më pas u transmetohen fëmijëve. Përralla nuk është vetëm universale; nuk është e njëjta thelb dhe e njëjta histori me fytyra të ndryshme, por përrallat janë në thelb të ndryshme në kombe të ndryshme. Në këtë mënyrë, përralla qëndron mes psikologjisë së fëmijës dhe psikologjisë sociale; arsimimit dhe psikologjisë kulturore. Studimi i përrallave prek shumë disiplina. Ky është një tjetër fakt i cili dëshmon pasurinë dhe vlerat e tyre.

Fjalë çelës: *përralla, fëmijë, edukim*

Abstract

The existential motives and conflicts treated in fairytales express the early events and convictions of a people, which after they have taken on symbols and phantasy, are then transmitted to children. The fairytale is not only universal; it is not the same gist and the same storyline with different faces, but the fairytales are essentially different in different nations. In this way, the fairytale lies between the child psychology and social psychology; education psychology and cultural psychology. The study of fairytales touches many disciplines. This is another fact which testifies their richness and values.

Keywords: *fairytales, children, education*

Hyrje

Përrallat përfaqësojnë formën më të bukur të ndërthurjes së imagjinatës, fantazisë dhe mistikes me kulturën e një kombi. Për këtë arsye, funksionet e përrallave janë të shumta dhe studimi i tyre është njëkohësisht intrigues, interesant por aspak i lehtë.

Si pjesë e trashëgimisë folklorike të një populli, ashtu si çdo komponent tjetër kulturor, përralla është patjetër një formë e shprehjes së fizionomisë sociale dhe psikologjike të një populli. Ashtu si shumë elementë të tjerë etnografikë, ashtu si veshjet karakteristike, zakonet, letërsia, arti, traditat, arkitektura, të cilat ndikohen nga një sërë faktorësh ku bëjnë pjesë historia, pozicioni gjeografik, marrëdhëniet mes popujve, vecoritë kombëtare, politika, edhe përralla nuk mund t'i shpëtojë specifikave të karakterit kombëtar.

Duke qenë se përrallat janë një përfaqësim shumë i qartë i psikologjisë masive të një populli, motivet e tyre, historitë dhe personazhet përkatëse kanë dallime të rëndësishme në vende të ndryshme. Do të ishte një gabim shumë naiv e fëmijënor të mendohej se përrallat janë universale për nga përmbajtja e tyre. Si një element i fizionomisë së një populli, përralla zbulon shumë rreth asaj culture në të cilën është krijuar, ku është rrëfyer brez pas brezi, ku është zhvilluar dhe ku është pasuruar (Bettleheim, 1980).

Pra, përralla nuk është vetëm universale; nuk është e njëjti thelb dhe i njëjti bosht me fytyra të ndryshme, por përrallat janë thelbësisht të ndryshme në kombe të ndryshme.

Kështu, përralla gjendet mes psikologjisë së fëmijës dhe asaj sociale; psikologjisë së edukimit dhe asaj kulturore. Studimi i përrallave prek shumë disiplina. Ky është një fakt tjetër i cili dëshmon për pasurinë dhe vlerat e tyre.

Motivet dhe konfliktet ekzistenciale që trajtojnë përrallat shprehin ngjarjet dhe bindjet e hershme të një populli, të cilat pasi janë veshur me simbole dhe fantazi u përcillen fëmijëve.

Sfondi teorik

Përralla është një produkt social. Ajo është një nga format më të thjeshta të shprehjes së mendimit dhe përvojës psikologjike të një kombi. Sic përkufizon Marie Louise von Franz (1970), “përralla është shprehje e proceseve psikike të pandërgjegjshmes kolektive”. Kjo do të thotë se nëpërmjet metaforave dhe simbolikave të përrallave mund të lexojmë shumë qartë dhe thjesht përmbajtjen e tyre. Nëse do të bazoheshim mbi interpretimet psikanalitike të përrallave dhe të zbërthenim përmbajtjen e tyre sipas kësaj “gjuhe”, do të gjenim shumë forma të shprehjes së idi-t, egos-s dhe të superegos. Por në këtë punim, përrallat do të studiohen sipas një këndvështrimi më makro, kulturor, social dhe jo sipas një optike të psikologjisë psikanalitike.

Popullariteti i përrallave dhe fakti që janë kaq të pëlqyera nga fëmijët, në cdo periudhë dhe në cdo kulturë, dëshmon jo vetëm për vlerat, por dhe për pëlqyeshmërinë e tyre nga fëmijët (Von Franz, 1975).

Përralla, më shumë se cdo mjet tjetër komunikimi dhe edukimi, arrin ta pasurojë jetën e fëmijës pikërisht sepse është shumë empatike me nevojat e tij emocionale. Fëmijët i përqafojnë përrallat që në moshë shumë të hershme dhe e kuptojnë shumë mirë se nuk është fjala për një alternativë argëtimi cfarëdo, që prindi ia tregon thjesht për të kaluar kohën. Kjo ndodh sepse përralla është një burim shumë i mirë me anë të së cilës fëmija orientohet mbi mënyrën e funksionimit të marrëdhënieve njerëzore. Përveçse është orientuese dhe udhëzuese për fëmijën, nga ana tjetër ai e gjen veten emocionalisht në përrallë. Tensionet dhe konfliktet e brendshme psikologjike që përjeton fëmija, marrin zë në përralla. Për këtë arsye fëmija e vlerëson përrallën si një nga rrugët kryesore të zgjidhjes së vështirësive që ka, përgjatë procesit të gjatë dhe të komplikuar që paraqet zhvillimi i tij. Përralla pra, i thjeshtëzon fëmijës procesin e rritjes, duke i treguar shumë qartë që jeta është e përbërë prej problemeve, të cilat nisin herët në jetë. Përralla i tregon atij se një pjesë e madhe e problemeve vjen prej vetë natyrës njerëzore; ndërsa një pjesë tjetër shkaktohet nga instiktet dhe impulset e brendshme. Këtu del në pah pavetëdija me parimin e kënaqësisë së menjëhershme (Von Franz, 1980).

Bashkë me ekzistencën e problemeve dhe vështirësive, përralla i mëson fëmijës që zgjidhja është përherë e mundur. Duke marrë parasysh ankthin kryesor të fëmijërisë së hershme, ankthi i ndarjes nga prindërit, përralla ka përshtatur një zgjidhje. Praktikiteti i përrallës, siguron një fund të lumtur. “Jetuan të lumtur përgjithmonë” është postulati i famshëm, që me shumë mendime dhe intuitë shërben për të lehtësuar këtë burim të madh shqetësimi që ka fëmija. Njëkohësisht, kjo zgjidhje e shprehur në formë slogani, jep mesazhin që për t’i bërë ballë jetës, kemi nevojë për të krijuar një raport të mirë me një person tjetër. Duke i treguar fëmijës se cilat janë zgjidhjet alternative për ankthin e ndarjes, përralla ka për synim t’i shpjegojë fëmijës se kuptimin e vetes dhe krijimin e vërtetë të identitetit të tij, ai do ta gjejë jashtë raportit me nënën. E qetëson kështu pra, duke i shprehur se ankthi nga ndarja dhe frika që ka nga braktisja prej figurës më të dashur, e cila është burim i pakushtëzuar i mirësisë, kujdesit, dashurisë, vëmendjes, afeksionit, mund të anashkalohet duke krijuar një raport të shëndetshëm jashtë rrethit familjar. Ky mesazh pra, njëkohësisht i shërben disa qëllimeve për mirëritjen e fëmijës; ul ankthin e ndarjes duke e zhvendosur atë në një tjetër marrëdhënie, nxit individualitetin dhe pavarësinë jashtë sigurisë së familjes dhe nxit procesin e socializimit të fëmijës, që është thelbësor për një rritje dhe zhvillim të shëndetshëm. Pa harruar këtu, që përralla e orienton fëmijën drejt të ardhmes, dmth drejt rritjes, zhvillimit, evoluimit, plotësimit (Santagostino, 2013).

Përfundimet e lumtura të përrallave nuk shprehin finalizimin e të gjithë jetës në një rrëfim të vetëm. Përralla nuk i thotë fëmijës se sapo të rritet dhe të krijojë individualitetin e tij, ai nuk do të ketë më asnjë lloj problemi për të zgjidhur. Përkundrazi, përralla mëson se përherë do të ketë probleme, por në një përrallë

zgjidhet një nga konfliktet e brendshme të fëmijës. Për këtë arsye, ka shumë përralla, sepse dhe llojet e vështirësive që mund të hasë fëmija janë të ndryshme e të larmishme.

Roli që kanë përrallat në edukim dhe në zhvillimin e fëmijëve

Duke qenë se përrallat tregohen në moshë të hershme, pa më të voglin dyshim, ndikimi i tyre është shumë i madh dhe roli i tyre është përcaktues në zhvillim.

Një zhvillim i shëndetshëm përfshin pa përjashtim dhe një fëmijëri të pasur me rrëfim përrallash, të cilat janë njëkohësisht argëtuese dhe jashtëzakonisht edukuese.

Fëmija ka nevojë të gjejë veten dhe të përcaktojë vendin që zë në mjedisin e tij social. Përralla e ndihmon shumë në këtë drejtim. Për më tepër, përralla jep mesazhe të domosdoshme mbi raportet njerëzore, moralin, të drejtën dhe të mirën. Sado anakronike të mendohet se është ajo, vlera edukuese e saj është e patjetërsueshme, duke qenë se është pra një nga instrumentet që më së miri kryejnë këtë funksion.

Sado e vjetër të jetë përralla, magjia e saj qëndron në faktin se ajo përcjell mesazhe në nivel të pandërgjegjshëm duke iu përshatur më së miri psikologjisë së fëmijës. Pikërisht këtu, në domethënien dhe vlerën e saj përtej kohës, qëndron dhe universaliteti i përrallave. Universalitet i cili kalon dimensionet kohore dhe hapësinore dhe që është argumenti më bindës lidhur me besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre.

Këto të fundit (besueshmëria dhe vlefshmëria) janë konstrukte shumë të rëndësishme që nuk mund t'i lëmë mënjanë kur vjen puna tek një punim shkencor. Nuk ka sesi të mos besojmë tek vlera dhe efikasiteti i përrallave, derisa prindërit, gjyshërit, edukatorët e cdokush tjetër që rrit, edukon dhe arsimon fëmijë, prej vitesh, dekadash e shekujsh, ka besuar tek fuqia edukuese e përrallës (Von Franz, 1968).

Një benefit tjetër i të treguarit të përrallave është se për nga mënyra sesi janë ndërtuar dhe konceptuar, ato u japin përgjigje një numri shumë të madh çështjesh. Përralla shërben kështu si një manual për fëmijën, i cili gjen përgjigje për dilemat e veta, për konfliktet e brendshme, për aspekte të ndryshme të funksionimit të botës, duke ofruar zgjidhje për pyetje ekzistenciale që fëmija ka; pyetje të cilat ndonjëherë fëmija nuk di sesi t'i formulojë dhe nuk di kujt t'i drejtohet.

Si një prej literaturave më tradicionale e të hershme dhe duke qenë se i përgjigjet herë në mënyrë të tërthortë e herë në mënyrë të drejtpërdrejtë pyetjeve të fëmijëve, përralla ndikon direkt në socializimin e tyre dhe si një faktor orientues mbi shpjegimin e funksionimit të marrëdhënieve njerëzore.

Marrëdhënia e përrallës me fantazinë është e ndërsjelltë; në një kohë që përralla bazohet tek imagjinata, ajo ndikon pozitivisht në zhvillimin e kësaj karakteristike tek fëmijët. Pra, jo vetëm që është e ndërtuar mbi magjinë e fantazisë, por një fëmije që i tregohen përralla do ta ketë atë edhe më të zhvilluar sesa një bashkëmoshatar i tij i cili nuk është ekspozuar ndaj tyre.

Përralla nuk ka qëllim kryesor t'i tregojë fëmijës aq shumë fenomene të realitetit të jashtëm, sesa ka për objektiv të merret me dinamikën e tij të brendshme. Për këtë arsye, ajo nuk i qëndron besnike ngjarjeve reale dhe riprodhimit të realitetit të jashtëm. Nëse do të kishte këtë qëllim, pra të riprodhonte ndodhitë dhe përvojat e paraardhësve, përralla do të ishte shumë përshkruese dhe nuk do të kishte nevojë për fantazinë. Por, duke qenë pikërisht se i referohet realitetit të brendshëm psikologjik, përralla shprehet me simbolika të shumta. Do të ishte shumë më e varfër, konkrete dhe lineare nëse do të përqendrohej vetëm tek realiteti i jashtëm. Vetëm nëpërmjet simbolizmit, gjuhës së imazheve, personazheve imagjinare dhe fantazisë, e pandërgjegjshmja dhe konfliktet e fshehura mund të marrin jetë dhe të përkthehen në formën e përrallës. Përralla e cila flet me fantazinë, pra me gjuhën e fëmijës, i tregon atij se kontradiktat e brendshme që ai mund të ketë por si shpreh dot, nuk qenkan vetëm të tijat individuale, por qenkan problematika më të gjera dhe të përgjithshme. Duke gjetur zgjidhje për dinamikën e brendshme psikologjike nëpërmjet përrallave, fëmija kupton një gjë shumë të rëndësishme dhe ngushëlluese për rritjen e tij të shëndetshme psikologjike. Ai mëson se nuk është i vetëm në përjetimet e tij dhe në skutat e pavetëdijshme (Bettleheim, 1980).

Pikërisht ky ndërgjegjësim është një komfort emocional shumë i dobishëm.

Frika e paarsyeshme e disa prindërve që fëmijët me anë të fantazisë dhe elementëve përbërës të përrallës, do të krijojnë ide të pasakta mbi realitetin, është e pavend. Nuk mund të mendohet se fëmija do të krijojë "varësi" ndaj ngjarjeve dhe episodeve imagjinare dhe nuk do të dijë të përballet me realitetin. Fëmija rritet me anë të fantazisë dhe zhvillohet me anë të imagjinatës. Sipas këtij këndvështrimi, përralla i shërben

pikërisht këtij qëllimi.

Përralla bën një lloj katarsisi të përjetimeve të brendshme të fëmijës. Nëse ajo do t'i mungonte jetës së fëmijës, mund të ndodhte që të shtypeshin instiktet dhe impulset e brendshme. Nëse fëmija do të kufizohej tërësisht nga kjo formë simbolike e të shprehurit, do të rrezikonte të represonte shumë dinamika të brendshme dhe rezultati nuk do të ishte aspak pozitiv për zhvillimin e tij. Nëse fëmija do të kufizohej nga shprehjet e pandërgjegjshme nëpërmjet tregimit të përrallave, ai thjesht do të privohej nga një burim i natyrshëm ndjesish, informacionesh dhe përvojash. Pra, "akuzat" ndaj përrallave si nxitëse të ankthit, frikës ndaj personazheve imagjinare dhe jorealiste, nuk janë të sakta dhe të bazuara mbi argumente që ecin paralel me parimet e zhvillimit të fëmijëve. Personazhet janë ose shumë të mirë ose shumë të këqinj; ose të bukur ose të shëmtuar; ose inteligjentë ose shumë mendjelehtë; ose shumë të varfër, ose shumë të pasur. Ekziston një polaritet dhe një ndarje ekstreme e drastike e të gjitha vecorive dhe karakteristikave të ngjarjeve dhe personazheve, por kjo ndodh sepse pikërisht kështu funksionon dhe mënyra e të menduarit të fëmijës. Fëmija në moshën që njihet dhe prezantohet me përrallat, nuk e ka ende të zhvilluar të menduarit abstrakt dhe deduktiv. Kështuqë, në mënyrë që të kuptojë se cili është standardi moral dhe se cilat janë sjelljet socialisht të pranueshme, diferencat dhe ekstremet e ndihmojnë fëmijën që të pozicionohet më lehtë dhe të identifikohet me personazhin e mirë dhe heroin e përrallës.

Në nivel psikologjik, përrallat e ndihmojnë fëmijën të ulë ankthin, pasiguritë dhe frikërat. Fëmija në shumicën e rasteve do të identifikohet me personazhin kryesor, pra me heroin dhe protagonistin e historisë. Ky identifikim do ta ndihmojë fëmijën të kuptojë se ashtu si heroi i përrallës, edhe ai do të kalojë nëpër peripeci, sfida dhe vështirësi, të cilat janë të pashmangshme për ta bërë atë fitimtar. Kjo është analogjia që i tregon fëmijës se ashtu si heroi i përrallës edhe procesi i tij i rritjes dhe maturimit kalon nëpër stadi e pengesa të ngjashme.

Të gjitha këto motive fëmija është në gjendje t'i kuptojë vetë, pa pasur nevojë për shpjegime dhe interpretime. Fëmijës nuk do t'i thuhet shprehimisht se procesi i tij i zhvillimit do të ndjekë një rrugëtim të caktuar, në fund të të cilit ai do të jetë më i rritur, më i mirë, më i ditur. Nuk ka nevojë që rrëfimi të përdoret në mënyrë kaq direkte, pasi qëllimi kryesor i përrallës është edukativ më shumë sesa didaktik (Zippe, 1995).

Përralla kryen dhe një funksion terapeutik, për sa kohë që i mundëson fëmijës të projektojë cdo emocion dhe përderisa shërben si qetësim për konfliktet e brendshme. Nuk janë të panjohura rastet e studiuesve dhe të terapistëve (Paola Santagostino, Loiusa Duss) të cilët gjatë praktikës së tyre klinike e kanë përdorur përrallën si një teknikë të mirëfilltë terapeutike, jo vetëm për të marrë informacion në castin e vlerësimit, por edhe më tej në castin e ndërhyrjes dhe trajtimit. Kjo shpreh shumë qartë se përdorimi i imagjinatës dhe fantazisë gjen vend në kurimin e tensioneve psikologjike dhe afektive. Duke e përdorur përrallën si një mekanizëm dhe si një instrument projektiv, transferohen jashtë vetes ndodhitë dhe ngjarjet që përjeton pacienti. Në këtë mënyrë, simbolizmi i përrallave i ofron individit forma alternative të shprehjes, të lira, kreative, origjinale, individuale.

Megjithatë, ky punim nuk ka për qëllim të përqendrohet tek ndikimi i përrallës në psikologjinë individuale. Këndvështrimi sipas të cilit do të analizohen përrallat lidhet me përkufizimin e tyre si një nga format më të qarta dhe të pastra të shprehjes së psikologjisë masive, ose sic do të thoshte Marie Loiusa Von Franz (një prej studiuesve kryesore dhe interpretimit të përrallave) "të proceseve psikike të të pandërgjegjshmes kolektive".

Këtu ka një të vërtetë shumë të madhe bazuar mbi një argument shumë të thjeshtë. Po të kthejmë vëmendjen nga zanafilla e origjinës së përrallave, përralla e parë në historinë e njerëzimit mendohet të ketë qenë rreth viteve 1250 para.K. Vetëdija për edukimin e fëmijëve sigurisht që nuk mund të ketë qenë faktori kryesor i krijimit të përrallës si një kategori fillimisht letrare dhe kulturore apo si një rrëfim me qëllim argëtues për fëmijën. Kështu që, me të drejtë mund të mendojmë se përralla ka ardhur si rrëfim, ku tregoheshin histori, të cilat të veshura pas elementëve fantastikë dhe magjikë, arrinin të tërhiqnin më shumë vëmendje. Në këtë mënyrë, përralla mund të depërtonte më lehtë, të fitonte popullaritet më shpejt dhe të merrte vlera duke u përdorur gjerësisht brez pas brezi. Pikërisht këtu, zë fill koncepti i këtij punimi.

Duke marrë parasysh si kanë lindur përrallat, në mënyrë të përmbledhur do të konsiderojmë se për nga mënyra sesi janë krijuar dhe kanë ardhur deri në ditët e sotme, të gjitha ndryshimet ndër vite na sjellin sfondin kulturor, social, dhe psikologjik nga i cili vijnë. Që do të thotë gjithashtu se në mënyrë të pashmangshme, përralla na ka sjellë të gjithë trashëgiminë e kontekstit dhe kombit nga i cili vjen, në terma të personalitetit dhe karakterit kombëtar.

Motivet që gjenden më shpesh nëpër përralla

Fakti që një pjesë e madhe e personazheve në përralla nuk kanë një emër të përvencëm, por mbeten thjesht të emërtuar sipas lidhjeve të gjakut apo atyre familjare, u lejon fëmijëve të projektojnë elementë të marrëdhënieve të veta mbi ta. Shumica e përrallave kanë personazhe si nëna, babai, vëllezërit, motrat, njerka, gjyshja, princi apo princesha. Në këtë mënyrë fëmija mund të identifikohet, të gjejë veten apo të identifikojë një prej njerëzve të afërt të tij tek personazhi përkatës (Zippe, 2001).

Pse përrallat nisin me shprehje të tilla “Na ishte njëherë...”, “Shumë kohë më parë në një mbretëri të largët...”?

Kjo formë distante dhe e largët e rrëfimit, e zhvendosur në kohë dhe hapësirë, automatikisht e vendos fëmijën në një dimension imagjinar sapo përralla nis të rrëfëhet. Që prej fillimit, fëmija është i vetëdijshëm që nuk bëhet fjalë për vende dhe data reale. Kur i prezantohet përralla me “njëherë e një kohë”, bëhet e ditur se ajo që do të dëgjojë nuk ka të bëjë me realitetin që ai jeton cdo ditë. Rrëfimet dhe historitë duket sikur vijnë nga thellësia e kohës dhe për t’ja sjellë fëmijës në formë tregimi duhet te pastrohen nga pluhuri i harresës. Pikërisht për këtë vecori të përrallave, ato asociohen shpeshherë si një komunikim që u përket gjyshërve. Ashtu si përralla është e vjetër, aq sa nuk e dimë se nga vjen dhe sa kohë ka që është krijuar, gjyshi apo gjyshja është një person shumë i përshtatshëm për t’ja përcjellë atë fëmijës. Duke qenë që përralla përfaqëson mcurinë popullore të mbledhur ndër breza; në mënyrë analoge gjyshërit dhe gjyshet janë njerëzit që në sytë e fëmijës e mbartin gjithashtu këtë karakteristikë. Përralla përshkrohet nga një rrëfim mistik sepse ka ngjarje që nuk përputhen me të tashmen dhe misterioz sepse ka shumë detaje të papërcaktuara dhe të paspecifikuara qartë. Njëherë e një kohe kafshët flisnin, njerëzit shndërroheshin në objekte pa jetë dhe anasjelltas, mbretërit kishin zakonisht 3 djem apo 3 vajza, ekzistonte një njerëz dashakeq, një shtrigë mizore apo një zanë që bënte mrekulli. Fëmija e di shumë mirë që të gjitha këto ishin “njëherë e një kohë”, në një kohë të pacaktuar dhe jo sot. E megjithatë, përralla mbetet shumë bindëse dhe tërheqëse për të.

Përveç motivit të hyrjes dhe mënyrës sesi nis të komunikohet, një ndër vlerat më të pikasura të përrallave që ka ndikuar në shtimin e popullaritetit të tyre masiv në fëmijëri, lidhet me motivin e fundit të lumtur. Që një fëmijë të rritet i shëndetshëm, ai ka nevojë të dijë që gjërat dhe problemet, sado të komplikuar të jenë, në fund marrin zgjidhje. Përralla pra ushqen frymën e shpresës dhe optimizmit. Këtu nuk është fjala për një shpresë të rremë që fëmijës t’i krijohen pritshmëri dhe përshtypje të gabuara mbi realitetin. Por është fjala për fantazitë dhe iluzionet për të cilat ka nevojë dhe që e ndihmojnë të zgjidhë problemet. Frikërat dhe ankthet irracionale të fëmijës kërkojnë zgjidhje dhe alternativa të tilla imagjinare, sepse sigurisht që dhe problematikat e tij emocionale janë të ndryshme nga realiteti i të rriturve.

Një motiv që gjendet shpesh në përralla, është ai i fëmijës naiv, mendjelehtë dhe më pak të favorizuar se të tjerët, në terma të pamjes apo karakterit. Një motiv i tillë, është ngushëllues për fëmijën i cili e gjen veten në rolin e më të voglit. Një shembull shumë i thjeshtë është ai i Rosakut të vogël të shëmtuar. Si rrjedhojë e pamjes së tij jo shumë të këndshme, ky personazh ka bërë një jetë modeste ku është ndjerë përherë i nëpërkëmbur. Megjithatë, kur i paraqiten sfidat, ai ia del mbanë me sukses, me thjeshtësinë dhe mirësinë e tij, duke u kthyer në hero dhe protagonist. Modele të tilla janë shumë të dobishme për fëmijën, i cili ka nevojë të kuptojë rëndësinë e rritjes në mënyrë graduale dhe që të mund të pranojë pa problem statusin e tij si më i vogli në familje. Duke qenë se koncepti i tij për veten në këtë mënyrë është plotësisht i justifikuar, fëmija duke u identifikuar me këtë personazh përralle, njëkohësisht mëson se potencialet e tij do të realizohen nëpërmjet një procesi të natyreshëm dhe spontan të rritjes dhe përvojave të ndryshme. Në të njëjtën kohë, motivi i fëmijës që nuk është i lumtur si rrjedhojë e mënyrës sesi trajtohet në familje apo

sepse përbuzet nga të tjerët dhe që në fund merr vlerësimin dhe dashurinë që i takon, i shërben dhe vendosjes së sensit të drejtësisë. Fundi i lumtur pra, është një nga boshtet kryesore konceptuale të përrallës, kështu që fakti që në fund secili shkon në vendin e tij, e ndihmon fëmijën dhe në këtë drejtim. Rast tjetër tipik është Hirushja, jeta e së cilës ishte në kontrast absolute me motrat dhe njerikën. Por, falë durimit, mirësisë dhe rrethanave, ajo ja del të ketë një jetë të kënaqshme, të paqte dhe prej princeshe, ashtu sic e meriton. Në këtë mënyrë pra, fëmija identifikohet me personazhin më pak të përkëdhelur nga fati në përralla, nëpërmjet rrugëtimit të tij.

Motivi i shpjeguar më lart nënkupton dhe vlerën që ka të vepruarit dhe të qenit aktiv në jetën e fëmijës. Fitimi i autonomisë, pavarësisë dhe krijimi i besimit tek vetja është thelbësor që fëmija të krijojë një personalitet të shëndetshëm. Fakti që personazhi kryesor, heroi apo heroina e përrallës duhet të kalojë nëpër një kalvar të gjatë vështirësish dhe sprovash, tregon që asgjë nuk mund ta marrë për të mirëqenë, por që duhet ta fitojë vetë. Kështu, fëmija kalon qartazi procesin e maturimit. Për të arritur pavarësinë dhe për të krijuar identitetin e vet të shkëputur nga prindi, fëmija duhet t'i përballojë vetë sfidat dhe vështirësitë që i dalin përpara. Kjo ndikon gjithashtu në edukimin e një lokusi të brendshëm të kontrollit tek fëmijët.

Bibliografi

1. Bettelheim, B. "The Uses of Enchantment: The Meaning and Importance of Fairy Tales" 1977, Vintage Publishing, 1980.
2. The Interpretation of Fairy Tales Paperback by Marie-Louise Von Franz, 1975.
3. Psychological Meaning of Redemption Motifs in Fairy Tales (Studies in Jungian Psychology) Paperback by Marie-Louise Von Franz, 1980.
4. Shadow and Evil in Fairy Tales (A C.G. Jung Foundation Book) (C. G. Jung Foundation Books) by Marie-Louise Von Franz, 1968.
6. Come raccontare una fiaba e inventarne cento altre (How to tell a fairytale and invent 100 others) by Paola Santagostino, 2018.
7. Guarire con una fiaba. Usare l'immaginario per curarsi (Healing with a fairytale. Using the imaginary to heal) by Paola Santagostino, 2013.
8. Il metodo delle favole in psicanalisi infantile (The fairytale method in the infantile psychoanalysis) by Louisa Duss, 1975.
9. The Great Fairy Tale Tradition: From Straparola and Basile to the Brothers Grimm (Norton Critical Editions) by Jack Zipes, 2001.
10. The Oxford Companion to Fairy Tales 2/e (Oxford Companions) by Jack Zipes, 1995.
11. Morphology of the Folktale by V. Propp, 1992.
12. From The Beast To The Blonde: On Fairy Tales and Their Tellers by Marina Warner, 2000.
13. Don't Bet on the Prince: Contemporary Feminist Fairy Tales in North America and England by Jack Zipes. 2000.
14. Breaking the Magic Spell: Radical Theories of Folk and Fairy Tales by Jack Zipes. 2005.
15. Fairy Tales and the Art of Subversion (Routledge Classics) by Jack Zipes, 2010.
16. The Irresistible Fairy Tale: The Cultural and Social History of a Genre by Jack Zipes, 2007.
17. Once Upon a Time: A Short History of Fairy Tale by Marina Warner, 1988.
18. Individuation in fairy tales by Marie- Luise Von Franz, 1978.
19. Nasreddin Hodja- Tales of the Turkish Trickster (World Tales Series) by Compilation and editing: Eenvoudig Communiceren (1990)